



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 178/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi–Referues, z.Blerim Dina–Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “International Security Association” SHPK kundër vendimit për dhëni të kontratës gjatë rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit: “Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e administratës, Qendrës për punë sociale, arkivit të qytetit dhe shtëpisë së kulturës-Tender Lot 1” me nr.prokurimi 613-18-9147-2-1-1 të iniciuar nga AK-“KK Lipjan”, më datën 15. 05. 2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “International Security Association” SHPK kundër vendimit të aktivitetit të prokurimit: “Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e administratës, Qendrës për punë sociale, arkivit të qytetit dhe shtëpisë së kulturës-Tender” Lot 1 me nr.prokurimi 613-18-9147-2-1-1 të iniciuar nga AK-“KK Lipjan”.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit me titull: “Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e administratës, Qendrës për punë sociale, arkivit të qytetit dhe shtëpisë së kulturës-Tender- Lot 1” me nr.prokurimi 613-18-9147-2-1-1 të iniciuar nga AK-“KK Lipjan” dhe lënda kthehet në rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues“International Security Association” SHPK,aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:03.12.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt:08.01.2019

Data e përfundimit të ri- vlerësimit të ofertave: 04.04.2019

Njoftimi me letrën standarde idt: 04.04.2019

Kërkesa për rishqyrtim me dt:08.04.2019

Autoriteti Kontraktues me datën 10.04.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim si e pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues ekonomik “NT Inter Trading”- Prishtinësi palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me19 prill 2019 më numër 178/19,kundër vendimit për aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve komunale,ndërtesat e administratës,Qendrës për punë sociale,arkivit të qytetit dhe shtëpisë së kulturës-Tender” Lot 1 me nr.prokurimi 613-18-9147-2-1-1,duke pretenduar se janë shkelur dispozitat:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26. 04. 2019ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore, i cili në raportin e dt: 06.05.2019, konstaton dhe sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE se gjatë ngarkimit të platformës elektronike sistemi nuk na ka lejuar të ndajmë në lote çmimin konsiderojmë që ky pretendim nuk qëndron ngase në të njëjtën platformë OE tjerë i kanë ngarkuar çmimet sipas lotëve të ndara. OE ankues nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se ka pasur probleme të kësaj natyre në platformën e-prokurimi.

Oferta e OE "International Security Association" gjatë kalkulimit ka gabime aritmetikore që kalon vlerën mbi 2% dhe si e tillë është vlerësuar si ofertë e papërgjegjshme nga komisioni i vlerësimit. Konstatohet se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se gjatë kalkulimit të pagës bruto prej 200.00 € të kërkuar nga AK në dosjen e tenderit pjesa III pika 2.4 (OE DUHET TË DEKLAROHET SE PUNËTORËVE DO TUA PAGUAJ PAGËN MINIMALE BRUTO 200.00 €) dhe oferta e OE "Delta Security" i propozuar nga AK si fitues i mundshëm në shumë prej 166,817.04 € sipas pretendimeve të OE ankues duhet të shpallet e papërgjegjshme për shkak të çmimit të ulët. OE ankues "International Security Association për Lot 1 ka ofertuar në shumën totale prej 182,579.00 € dhe sipas pretendimit ankimor çdo ofertë tjetër me çmim më të ulët duhet të konsiderohet e papërgjegjshme, konsiderohet që pretendimi i OE ankues "International Security Association" është i bazuar. Bazuar edhe në vendimin PSH. nr. 46/19 dhe 49/19 të Panelit Shqyrtues të OSHP-së, pika II e këtij vendimi, AK ofertën e OE "Delta Security" është dashur ta shpallet si të papërgjegjshme për shkak të çmimit të ulët.

Oferta e OE të propozuar si fitues nga AK në vlerë prej 166,817.04 nuk e mbulon pagesën e pagave në shume bruto prej 200.00 € të kërkuar nga AK.

Koeficienti 1.27 i ofruar nga OE fitues i shumëzuar me 174 orë sipas ligjit të punës plus TVSH 18% si çmim total jep shumën prej 220.98€, ndërsa sipas kalkulimeve të kërkuara nga paga bruto prej 200,00 € dhe kontributit pensional të punëdhënësit prej 5% dhe TVSH prej 18%, shuma minimale për pagesën e pagave të punëtorëve duhet të jete se paku 247.80 €.

Konstatohet se pretendimi ankimor është i bazuar.

Gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve autoriteti kontraktues nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e ligjit të prokurimit publik.

Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, ekspert i shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht (pretendimi nr 2) për arsyen që i theksuam në përgjigjeje të pretendimeve ankimore të më sipërme.

AK nuk ka zbatuar vendimin e Panelit PSH. nr 46/19 dhe 49/19 të datës 19.03.2019, për vlerësimin dhe konstatimin se çmimi i ofruar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës a mund të plotësoj kërkesën e AK për pagën bruto prej 200.00 €.

AK gjatë fazës së ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar ofertën e OE fitues se çmimi i ofruar nga ky OE a është çmim jo-normalisht i ulët, por vetëm ka kërkuar një deklaratë nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës që mund të mbuloj pagën prej 200.00€ bruto (kjo deklaratë ka ekzistuar edhe në fazën e parë të vlerësimit para vendimit të OSHP-së).

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që ta kthejë në ri-vlerësim aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e administratës, Qendrës për punë sociale, arkivit të qytetit dhe shtëpisë së kulturës-Tender” Lot 1 me nr. prokurimi 613-18-9147-2-1-1 të iniciuar nga AK-“KK Lipjan” në bazë të dispozitave të LPP-së.

Operatori ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datë 23 prill 2019 ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues profesional.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datë 08 maj 2019 ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues profesional.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.05.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së deklaroj: “Ne kemi bërë parapë ankesë për shkak se OSHP me vendim herën e kaluar ka kërkuar që lënda të kthehet në rivlerësim, AK ka shpall parapë të njëjtin OE fitues për të cilin ne e kemi përsëritur në ankesën e dytë. Qëndrojmë pas ankesës”.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së z. Ramadani i cili deklaroj: “Kemi pasur disa oferta në këtë lot i kemi pas të planifikuar 170.000 euro dhe OE në këtë tender nuk kanë qenë me çmim abnormalisht të ulët, vendimi i OSHP-se ka qenë që të verifikohet i njëjti OE që të kërkohej sqarime shtesë se a do të mund ta përfundojë këtë kontratë dhe komisioni ka kërkuar sqarime që do të qëndrojnë mbrapa çmimeve të dhëna në DT. Dhe ne si AK nuk kemi mundur ta eliminojmë parasysh se ai qëndron mbrapa çmimeve të veta. OE ankues ka një gabim aritmetik që kalon vlerën 2 % në mendojmë që të jetë në fuqi vendimi i AK-se.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti teknik z. Papaj deklaroj: “Mbes pranë konstatimit që kjo procedurë të shkojë në rivlerësim për shkak që KK-Lipjan nuk e ka zbatuar këtë vendim që kërkon që çmimi i ofruar nga OE fitues a është çmim normalisht i ulët apo jo AK në këtë rast nuk e ka bërë vlerësimin mirëpo ka kërkuar nga OE fitues a mund të mbulojë pagat Bruto prej 200 euro. Sipas një analize që kam bërë OE fitues vjen me një ofertë prej 220 euro për punëtor. Në këtë rast pajtohem me ankesën e OE ankues.”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: “Kërkojmë nga paneli që të aprovoj kërkesën tonë si të bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: “Kërkojmë nga paneli që të refuzon ankesën e OE ankues dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-se”.

Paneli shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të ankesës së OE ankues, shoshitjes së fakteve dhe provave, deklarimeve të palëve, konstatoj se autoriteti kontraktues gjatë rivlerësimit të ofertave nuk ka respektuar vendimin e panelit shqyrtues PSH. nr 46/19 dhe 49/19 të datës 19.03.2019, sa i përket konstatimit të panelit shqyrtues se çmimi i ofruar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës a mund të plotësojë kërkesën e AK për pagën bruto prej 200.00 €. AK gjatë fazës së ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar ofertën e OE fitues se çmimi i ofruar nga ky OE a është çmim jo-normalisht i ulët, por vetëm ka kërkuar një deklaratë nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës se a mundet të mbulojë pagën prej 200.00€ bruto, e cila deklaratë ka ekzistuar edhe në fazën e parë të vlerësimit para vendimit të OSHP-së. Paneli shqyrtues e obligon autoritetin kontraktues që gjatë rivlerësimit konform nenit 59 par 4 dhe nenit 72 të LPP-së të verifikojë këtë çështje pasi që në të kundërtën do të merren masa konform LPP-së.

Paneli shqyrtues konstaton se AK me të drejtë e ka konsideruar të papërgjegjshëm OE ankues pasi që oferta e OE “International Security Association” gjatë kalkulimit konstatohet se ka gabime aritmetikore që kalojnë vlerën mbi 2% dhe si e tillë me të drejtë është vlerësuar si ofertë e papërgjegjshme nga komisioni i vlerësimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –KK Lipjan

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Goran Milenković

